

Në mbështetje të nenit 15.1 (d), 21.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 4 qershor 2008), dhe Rregullores nr. 01/2012 mbi kushtet dhe mënyrën e operimit të deltaplanëve dhe paraglajdëve të datës 10 tetor 2012,

Drejtori i përgjithshëm nxjerr këtë:

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 01/2018
Mbi procedurat për emërimin e ekzaminerëve të autorizuar për deltaplan/paraglajd

Neni 1
Fushëveprimi

- 1.1 Kjo urdhëresë definon procedurat dhe kriteret kualifikuese për emërimin e ekzaminerëve të autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës për të kryer ekzaminimet e provimit praktik për kandidatët të cilët aplikojnë për licencë të deltaplanit/paraglajdit.
- 1.2 Kandidati i cili aplikon për licencë apo autorizimin duhet të demonstrojë me sukses nivelin e kompetencës si pilot i deltaplanit/paraglajdit, duke i demonstruar procedurat dhe ushtrimet përkatëse në përputhje me privilegjet e licencës apo të autorizimit përkatës.
- 1.3 Licenca për pilot të deltaplanit/paraglajdit apo çfarëdo kufizimi apo zgjerimi të privilegjeve në licencë, lëshohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës.

Neni 2
Shkurtesat dhe definicionet

Shkurtesat dhe definicionet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimet si në vijim:

"AAC" - nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës të themeluar sipas Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil;

"Autorizim" - nënkupton dëshminë e trajnimit shtesë të pilotit të deltaplanit apo paraglajdit, i cili është i regjistruar në licencën e pilotit;

"Ditar i fluturimeve" (Flight logbook) - nënkupton regjistrin personal të fluturimeve të pilotit apo pilotit nxënës të deltaplanëve apo paraglajdëve;

“Ekzaminer” (Examiner) - nënkupton personin përgjegjës i cili ekzaminon provimin praktik të ndërlidhur me lëshimin e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit në emër të AAC-së në përputhje me standardet e përcaktuara nga AAC-ja;

“Instruktor i autorizuar i fluturimit”- nënkupton pilotin e deltaplanit apo paraglajdit me autorizimin valid të instruktorit të fluturimit, i cili vepron në kuadër të organizatës së aprovuar të trajnimit (ATO) për trajnimin e pilotëve të deltaplanëve apo paraglajdëve;

“Kandidat (aplikues)”- nënkupton aplikuesin për ekzaminimin (teorik dhe/apo praktik (fluturim)) për marrjen e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit apo të autorizimit përkatës;

“Kompetencë”- nënkupton kombinimin e shkathtësive, njohurive dhe qëndrimeve që kërkohen për të kryer një detyrë sipas standardit të përcaktuar;

“Listë e ekzaminerëve”- nënkupton listën e ekzaminerëve nga fushat përkatëse të aktiviteteve të aviacionit të përgjithshëm të përcaktuar nga AAC-ja;

“Licencë e pilotit - (deltaplan apo paraglajd)”- nënkupton dokumentin i cili i mundëson mbajtësit të tij t'i kryej detyrat e pilotit të deltaplanit apo paraglajdit në përputhje me autorizimet e shkruara në licencë dhe varësisht prej llojit të licencës në posedim;

Neni 3

Kushtet e përgjithshme të emërimit të ekzaminerit për deltaplan/paraglajd

3.1 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës do të emëroj dhe autorizojë, brenda kufijve shtetërorë të Republikës së Kosovës, ekzaminerët për deltaplan/paraglajd për një periudhë të caktuar kohore.

3.2 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës do të përcaktojë numrin e ekzaminerëve të autorizuar duke pasur parasysh numrin e shpërndarjes gjeografike të kandidatëve të cilët aplikojnë për licencë të deltaplanit/paraglajdit.

3.3 Ekzamineri i autorizuar nga AAC-ja do të vlerësojë pjesën e provimit praktik (fluturimit) të kandidatëve për licencë të deltaplanit/paraglajdit, në përputhje me Nenin 24 të Rregullores Nr. 01/2012 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të deltaplanëve/paraglajdëve.

3.4 Ekzamineri i cili administron provimin praktik do të vërtetoj përmes regjistrit përkatës (formulari AACK/DSF/GAT-CHK 01) dhe ditarit të fluturimit të pilotit rezultatin e provimit praktik.

3.5 Me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit në mes të ekzaminerit dhe kandidatit për licencë të deltaplanit apo paraglajdit, ekzaminerit nuk i lejohet të ekzaminoj nxënësin të cilin e ka trajnuar.

3.6 Përmes raportit përfundimtar ekzamineri i autorizuar do të rekomandoj AAC lëshimin e licencës së deltaplanit apo paraglajdit për kandidatët e suksesshëm.

3.7 Provimi praktik duhet të kryhet në llojin e njëjtë të deltaplanit/paraglajdit, në të cilën kandidati ka kryer trajnimin.

Neni 4 **Kualifikimet e ekzaminerit**

4.1 Ekzamineri i autorizuar nga AAC-ja i cili do të kryej detyrat dhe funksionet e deleguara me këtë udhëzim administrativ duhet të:

- a) Posedoj licencë valide të deltaplanit/paraglajdit me vlerësim të instruktorit;
- b) Ketë së paku 300 orë fluturimi me deltaplan/paraglajd;
- c) Ketë njohuri dhe përvojë në tre lloje të ndryshme të deltaplanit/paraglajdit;

4.2 Lista e ekzaminerëve të autorizuar nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovë do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të AAC.

4.3 Përzgjedhja e ekzaminerëve do të përcaktohet nga Autoritetit i Aviacionit Civil i Kosovë që të sigurojë shmangien e konfliktit të interesit në mes të ekzaminerit dhe kandidatit, sipas pikës 3.5.

Neni 5 **Hyrja në fuqi**

Kjo urdhëresë administrative hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 25 janar 2018


Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm